



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	01
Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No:	05-6403
Nr.i faqeva Br.stranica No.pages	-04-
Date:	25.10.13
Prishtinë / La	

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

SPITALI SHEIKH ZAYED VUSHTRI

dhe

SHOQATËS “GJYSMËHËNA E KUQE” E EMIRATEVE TË BASHKUARA
ARABE

Neni 1

Palët në rastin e nënshkrimit përfaqësohen nga:

1. Ministria e shëndetësisë e Republikës së Kosovës (MSH) të cilën e përfaqëson Ministri i Shëndetësisë, Prof. Dr. Ferid Agani, adresa: Rr. Zagrebit p.n. Prishtinë.
2. Spitali Sheikh Zayed Vushtri – Kosovë, përfaqësuar nga drejtori i saj Dr. Rexhep Kovaçi në vijim të dy institucionet e Republikës së Kosovës – Përfitues të donacionit

dhe

Shoqatës “Gjysmëhëna e Kuqe” e Emirateve të Bashkuara Arabe – zyra ne Shqipëri, me seli ne Rrugen “Sulejman Delvina” Tirana e Re e përfaqësuar nga drejtori i saj z. Hamad Ben Abdennabi, me zotësi te plotë juridike për të vepruar në vijim Donatori

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi efektiv, përcaktimi i të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë përkatëse të palëve për zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi – respektivisht për ndërtimin e një kati shtesë mbi spitalin ekzistues në Komunën e Vushtrisë dhe të një impianti për përpunimin e mbetjeve të këtij spitali.

Neni 3

Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve

1. Të drejtat dhe detyrimet e donatorit janë:

- 1.1. Të sigurojë e realizojë donacionin për ndërtimin e objekteve sipas projektit, preventivit e situacioneve përkatëse.
- 1.2. Të lidhë kontratën e sipërmarrjes (ndërtimit) si dhe kontratën e furnizimit me paisje e aparatura të objekteve me shoqëritë fituese të tenderit të përcaktuara nga komisioni i përbashkët i organizimit dhe realizimit të Tenderit.
- 1.3. Të ndjekë me rigorozitet dhe efektivitet zbatimin e kontratave të lidhura me subjektet e përcaktuara sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe përcaktimeve kontraktore të nënshkruara nga Palët.
- 1.4. Të marrë masat e nevojshme për përfundimin e objekteve në afat, me cilësi e standarte bashkëkohore.
- 1.5. Mbikëqyrja e punimeve dhe hartimi i dokumentacionit identifikues sipas fazave dhe llojit të ndërtimeve, supervizioni i punimeve dhe marrja në dorëzim e tyre do të trajtohen e përcaktohen me hollësi në Kontratën e Sipërmarrjes.
- 1.6. Pas përfundimit t'i dhurojë me Kontratë ligjore objektet përfituesve të donacionit respektivisht pranuesve të dhurimit.

2 – Të drejtat dhe detyrimet e përfituesve të donacionit

- 2.1. Ministria e Shëndetësisë:
- 2.2. Të pranojë donacionin e nevojshëm me destinacion për spitalin e Komunës së Vushtrisë duke hartuar e miratuar dokumentacionin e duhur ligjor.
- 2.3. Të bashkërendojë punën për hartimin e dokumentacionit teknik (projekt, preventiv, etj.) të nevojshëm për ndërtimin e objekteve.
- 2.4. Të ndihmojë e kontrollojë punën e Qendrës spitalore – Vushtri, për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe zbatimin e detyrimeve për mbarëvajtjen e punimeve.
- 2.5. Te marre përsipër e te pranoj pagesen e tvsh dhe te detyrimeve te tjera ligjore ndaj shtetit te Kosovës.
- 2.6. Te administroj objektet e dhuruara ,te caktoj e te paguaj personelin e nevojshem si pjese perberese e spitalit.

3. Spitali Sheikh Zayed Vushtrri

- 3.1 Të sigurojë nga organet e pushtetit vendor lejen e zhvillimit (përkatësisht lejen e ndërtimit të objektit).
- 3.2 Të sigurojë lejen mjedisore dhe dokumentacionin tjetër ligjor të nevojshëm për ndërtimin e objektit nga organet përkatëse kompetente.
- 3.3 Të sigurojë dokumentacionin e plotë teknik (si projekte, preventiv, planimetri, etj.) për ndërtimin dhe përfundimin e objektit.
- 3.4 Të krijojë kushte të përshtatshme për vazhdimin e punimeve nga shoqëritë e kontraktuara pa pengesa e ndërprerje të punës për shkak të Qendrës Spitalore si përfitues direkt të donacionit.
- 3.5 Te kujdesit për mirembajtjen e objekteve të dhuruara dhe trajtimin e personelit perkates si pjese perberese e godines se spitalit dhe stafit te tije.

4. Të Përbashkëta

- 4.1 Donatori dhe përfituesit e donacionit me bisedime e në bashkëpunim midis tyre të formojnë komisionin e tenderimit të objekteve me numër prej 5 (pesë) antarë, nga të cilët dy përfaqësues nga Donatori (shoqata), dy nga Spitali Sheikh Zayed Vushtrri dhe një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, si përfitues të donacionit.
- 4.2 Komisioni i tenderit të përcaktojë me vendim natyrën e tenderit (të hapur ose të kufizuar në përputhje e në zbatim të ligjeve në fuqi).
- 4.3 Të bëjë njoftimet përkatëse, të përcaktojë kriteret, të grumbullojë ofertat, t'i studioje e të shpallë me vendim të arsyetuar shoqëritë ndërtuese e furnizues me paisje.
- 4.4 Vendimi për firmat fituese të trajtohet e të miratohet nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve (donatorit e përfituesve të donacionit).
- 4.5 Shoqëritë fituese të tenderit Brenda 15 ditë të njoftohen për t'u paraqitur me dokumentat ligjore tek donatori për të lidhur kontratat përkatëse me donatorin për ndërtimin e objektit dhe furnizimin e instaliminin e paisjeve e aparaturave në objekt.
- 4.6 Të monitorojnë me përfaqësues të caktuar prej tyre ecurinë e punës sipas fazave e zërave të punimeve deri në përfundimin e tyre në afat, me cilësi e standarte bashkëkohore sipas preventivave e projekteve përkatëse.
- 4.7 Mbas përfundimit të punimeve në bashkëpunim me Komunën të organizojë ceremonine e inaugurimit dhe të dhurimit (pranim-dozimit) të objektit me dokumentacion ligjor nga donator te përfituesit e tij në shërbim të komunitetit në nevojë.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

- 5.1. Mosmarrëveshjet zgjidhen me bisedime midis palëve ose me rrugë ligjore.
- 5.2. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi hartohet në gjuhën shqipe, në 6 (gjashtë) kopje të njëjtë respektivisht nga dy kopje për secilën palë nënshkruese të saj.

Palët nënshkruese


Përfituesit e Donacionit:



Data: 24.10.13

Donatori:

z. Hamad Ben Abdennabi



Data: 25/6/2013

Dr. Rexhep Kovaçi

R. Kovaçi

Spitali Sheikh Zayed Vushtrri

Data: 25.10.13

